




Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 12 paragrafit 1, 2, pika d) të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit nr. 04/ - 110 Për Ndërtim, Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr. 02/2018 për Taksat Administrative për Leje Ndërtimore, Leje Rrërimi dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës, nenit 25 pika h), 27 paragrafit 1, të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643, dt.15 tetor 2008, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 02 korrik 2020, miratoi këtë:

**V E N D I M**  
**PËR MËNYRËN E PAGESËS SË TAKSËS ADMINISTRATIVE PËR LEJE**  
**NDËRTIMORE , LEJE RRËNIMI DHE TARIFAT PËR RREGULLIMIN E**  
**INFRASTRUKTURËS NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PRIZRENIT**

**Neni 1**

Qëllimi i këtij vendimi është mundësimi i pagesës me këste-rata, për investitorët-ndërtuesit e objekteve me qëllim të krijimit të lehtësimit të kushteve të paisjes me leje ndërtimi.

**Neni 2**

Shuma e pagesës së taksës administrative është e përcaktuar sipas vendimit mbi përcaktimin e Taksës Administrative për lëshimin e lejes së Ndërtimit dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës në Territorin e Qytetit të Prizrenit, Nr. 01/011-41141 të dt. 10 prill 2014.

**Neni 3**

1. Pagesa e taksës administrative e cila tejkalon shumës prej 30.000 – 100.000 euro, mund të bëhet në tri (3) këste të përshkruara si më poshtë:
  - a) Kësti i parë, pagesa prej 40%, ( para marrjes së Vendimit të Lejes dërtimore)
  - b) Kësti i dytë, pagesa prej 30% dhe
  - c) Kësti i tretë , pagesa prej 30% .
2. Punët ndërtimore në objekt investitori do ti zhvillojë në përputhshmëri të plotë me vlerën e këstit të miratuar, të shëndrruar në kate të ndërtimit, në të kundërtën në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspektoriateve do të ndërpriten punimet e ndërtimit.

**Neni 4**

Afati për përmbushjen e obligimit të përcaktuar sipas nenit 3 të këtij vendimi do të jetë dymbëdhjetë (12) muaj.  
Fillimi i afatit prej dymbëdhjetë (12) muajsh do të konsiderohet dita e marrjes në dorëzim të lejes ndërtimore.

- Neni 5**
1. Pagesa e taksës administrative e cila tejkalon shumës prej 100.000 euro, mund të bëhet në katër (4) këste të përshkruara si më poshtë;
- a). Kësti i parë, pagesa prej 30%, ( para marrjes së Vendimit të Lejes Ndërtimore)
  - b). Kësti i dytë, pagesa prej 25%,
  - c). Kësti i tretë, pagesa prej 25% dhe
  - d). Kësti i katërt, pagesa prej 20%.
2. Punët ndërtimore në objekt investitori do të zhvillojë në përputhshmëri të plotë me vlerën e kështit të miratuar, të shëndrruar në kate të ndërtimit, në të kundërtën në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspektoriateve do të ndërpriten punimet e ndërtimit.

**Neni 6**

Afati për përmbushjen e obligimit të përcaktuar sipas nenit 5 të këtij vendimi, do të jetë tetëmbëdhjetë (18) muaj.

Fillimi i afatit prej tetëmbëdhjetë (18) muajsh do të konsiderohet dita e marrjes në dorëzim të lejes ndërtimore.

**Neni 7**

Investitori – ndërtuesi, do të pajiset me faturë për shumën e përgjithëshme për pagesë në emër të Taksës Administrative për leje ndërtimore dhe e njejta do të paguhet me këste ashtu siç është përcaktuar në nenin 3 dhe 5 të këtij vendimi.

**Neni 8**

Obligohet: Drejtorja e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinorë, që sipas Ligjit nr. 04/ - 110 Për Ndërtim dhe akteve tjera ligjore në fuqi, t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme për aplikimin dhe zbatimin e taksave me këste-rata, të përcaktuara sikurse në nenin 3 dhe 5 të këtij vendimi.

**Neni 9**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinorë, Drejtorja e Inspektoriateve si dhe drejtoritë, sektorët-njësitë tjerë të përfshira për zbatimin e këtij vendimi.

**Neni 10**

Ky Vendim, hyn në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KOMUNA E PRIZRENIT**  
**Kuvendi i Komunës**  
**Nr. 001/011-60689**  
**Më: 02 korrik 2020**  
**Prizren**





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**



**Komuna e Prizrenit**  
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

**Kuvendi i Komunës**

**Nr. 001/011 –**

**Më: \_\_ mars 2026**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr.03/L-040 për Vetqeverisjen Lokale, nenit 27, paragrafi 1 të Statutit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, nr.01/011-5643 e datës 15 tetor 2008, bazuar në nenin 17, paragrafi 17.1, 17.2.1, 17.3, 17.4 dhe 17.5 të Rregullores 02/2025 për Varrim dhe Mirëmbajtjen e Varrezave të Reja të Prizrenit në Landovicë Nr.001/011-70340 e datës 03 qershor 2025, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më \_\_ mars 2026, miratoi këtë:

**PROPOZIM -VENDIM**  
**PËR CAKTIMIN E TARIFËS PËR SHËRBIMIN E VARRIMIT**  
**(Varrezat e Reja të Prizrenit në Landovicë)**

**Neni 1**

Miratohet ndryshimi i tarifës lidhur me shërbimin e varrimit (Varrezat e reja të Prizrenit në Landovicë).

**Neni 2**

Tarifa e shërbimit bazë të varrimit dhe mirëmbajtjes përcatohet në shumën prej 394.00 euro për një varr.

**Neni 3**

Kontributi vjetor i Komunës përcaktohet në shumën prej 65,300.00 euro.

**Neni 4**

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi, është Propozimi lidhur me rishikimin e tarifës së shërbimit të varrimit e operatorit, nr.05-352/05-0028397/26.

**Neni 5**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Shërbimeve Publike, operatori si dhe akterët e tjerë të përfshira në këtë projekt.

**Neni 6**

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, ky Vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikqyrës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr.08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr.24/2024 dhe pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

**Kryesues i Kuvendit**  
**Simir Krasniqi**


➤ **Drejtuar:** Drejtorisë për Shërbime Publike (Ekipit Menaxhues të Varrezave të reja të Qytetit në Landovicë)

**Kopje:** Z. Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit dhe Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit

**Lënda:** Plotësim i kërkesës për rishikim të tarifave të shërbimit për projektin PPP të Varrezave të Reja në Landovicë 05-352 130-414

**Datë:** 09.03.2026

Të nderuar,



Duke iu referuar kërkesës sonë të dorëzuar pranë Komunës së Prizrenit më 26.09.2025, lidhur me rishikimin e tarifave të shërbimit për projektin PPP të Varrezave të Reja në Landovicë, me këtë shkresë dëshirojmë të bëjmë një plotësim të kërkesës në fjalë, duke reflektuar disa përditësime në përlllogaritjet financiare.

Pas analizave shtesë dhe përditësimit të parametrave ekonomikë, tarifa e shërbimit të varrimit propozohet të përcaktohet në shumën prej **406.76 €**. Kjo vlerë reflekton ndikimin e inflacionit të akumuluar ndër vite, si dhe rritjen e kostove operative, përfshirë edhe rritjen e pagës minimale nga fillimi i vitit 2026.

Po ashtu, bazuar në përditësimin e kalkulimeve financiare, kontributi vjetor i Komunës propozohet të përcaktohet në shumën prej **65,300.00 €**, në mënyrë që të pasqyrojë më saktë parametrat financiarë dhe ekonomikë aktualë të projektit.

Vlerat e propozuara mbetet të shqyrtohen dhe përcaktohen në përputhje me vendimin e autoritetit kompetent, përkatësisht Komunës së Prizrenit apo nivelit qendror, sipas legjislacionit dhe procedurave në fuqi.

Ky plotësim paraqitet si pjesë përbërëse e kërkesës sonë të datës 26.09.2025 dhe synon të sigurojë një bazë më të saktë financiare për implementimin e qëndrueshëm të projektit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe gatishmërinë institucionale për trajtimin e këtij projekti me rëndësi për qytetarët e Komunës së Prizrenit, mbetemi të hapur për çdo sqarim shtesë dhe për vazhdimin e dialogut institucional.

Me respekt,

Rexhep Gashi – Drejtor

PZ Group sh.p.k



# **Analizë për rishikim të tarifave të shërbimit dhe kontributit Komunal për projektin PPP për varrezat në Landovicë të Prizrenit**

## **Hyrje**

Qëllimi i kësaj analize është të sigurohet një bazë objektive dhe e argumentuar për kërkesën zyrtare të rishikimit të tarifave të shërbimit në kuadër të kontrates për projektin PPP, Varrezat e reja në fshatin Landovicë të Prizrenit. Kjo synohet duke marrë parasysh inflacionin, vonesat institucionale në realizimin e projektit, efektin e tyre në situatën financiare të koncesionarit, si dhe detyrimet e Komunës së Prizrenit sipas kontratës dhe rregulloreve relevante. Analiza përfshin historikun, kontekstin ligjor, efektet ekonomike dhe parasheh një formulim të indeksimit, në përputhje me praktikatat më të mira dhe dispozitat ligjore relevante.

## **I. Historiku i projektit PPP të varrezave në Landovicë**

Projekti i varrezave të reja në Landovicë është një ndërmarrje e iniciuar nga Komuna e Prizrenit, me synimin për të ofruar një zgjidhje afatgjate, gjithëpërfshirëse e të standardizuar për nevojat e varrimit të qytetarëve të komunës, në një hapësirë prej rreth 58 hektarësh, të dedikuar dhe të organizuar për t'i shërbyer të gjitha komuniteteve dhe bashkësive fetare<sup>1</sup>. Projekti ishte menduar të implementohej si një Partneritet Publiko-Privat (PPP), në bazë të Kontratës së Nënshkruar më 2017 (numri i prokurimit PPP-16-085-611).

Megjithëse përgatitjet fillestare dhe procedurat teknike, ligjore e konsultimet publike ishin kryer gjatë viteve 2016-2017, projekti u përball me zvarritje institucionale që rezultuan në mos-zbatimin e projektit deri në vitin 2025. Në këtë periudhë, prona u bart rishtas në emër të komunës, u hartua dhe u konsultua me publikun rregullorja për varrim dhe mirëmbajtje, dhe vetëm më 2025 u hap rruga për finalizimin e përgatitjeve të fundit dhe zbatimin praktik të PPP-së<sup>1</sup>.

## **II. Sfidat e vonesave institucionale në zbatimin e projektit (2017-2025)**

### *Përmbledhje e shkaqeve kryesore të vonesave*

Realizimi i projektit është shoqëruar me pengesa që vijnë si rrjedhojë e faktorëve administrativë, institucionalë, dhe ndërlikimeve të pronësisë në të shkuarën. Mes tyre, evidentohen:

- Koordinimi i pamjaftueshëm institucional midis nivelit lokal dhe atij qendror për tjetërsimin dhe bartjen e pronësisë<sup>1</sup>;
- Burokraci dhe procese të zgjata lidhur me miratimin e planeve zhvillimore komunale dhe rregulloreve teknike;

- Mungesë harmonizimi të plotë mes legjislacionit për PPP-të dhe kërkesave specifike të infrastrukturës funerale;
- Konsultime të vazhdueshme publike për përfshirje sociale dhe fetare si dhe plotësim-konfirmimi i standardeve mjedisore;
- Ndryshim i profileve të nevojave demografike dhe urbanistike të qytetit në periudhën 2017-2025.

Sipas ekspertëve, vonesa të tilla, karakteristike për segmentin e PPP-ve në Ballkan, ndodhin shpesh për shkak të kuadrit ligjor jo tërësisht të harmonizuar, konfliktit të kompetencave dhe nevojës për konsultime të thella me grupet kyçe të interesit<sup>2</sup>.

#### *Efektet e Vonesave në Zbatimin e Projektit*

Këto vonesa kanë prodhuar pasoja të dukshme: humbje të të ardhurave të mundshme për koncesionarin, devijime të paralajmëruara në dinamikat financiare të kontratës, bllokim të kapitalit të investuar dhe shpenzime të tejzgjatura të mobilizimit të personelit, mirëmbajtjes së territorit, si dhe stërzgjatjen e ekspozimit ndaj rritjes së inflacionit.

Në këtë mënyrë, projekti nuk ka realizuar potencialin financiarë të planifikuar, ndërkohë që koncesionari është detyruar të bartë, përtej riskut të zakonshëm komercial, edhe riskun e vonesave institucionale, të parashikuar vetëm pjesërisht në kontratë, por të ndikuar fuqishëm nga faktorë të jashtëm<sup>3</sup>.

### **III. Ndikimi i inflacionit kumulativ në periudhën 2017-2025 në Kosovë**

#### *Analiza e inflacionit sipas burimeve zyrtare*

Normat vjetore të inflacionit në Kosovë kanë pasur variabilitet të konsiderueshëm, me rritje të ndjeshme në vitet 2021-2023 për arsye të faktorëve gjeopolitikë botërorë, rritjes së çmimeve të energjisë dhe inputeve bazë. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe burimeve të tjera të konsoliduara, normat mesatare të inflacionit për periudhën relevante janë si vijon<sup>45</sup>:

Viti	Norma vjetore e inflacionit (%)
2017	1.5
2018	1.1
2019	2.7
2020	0.2
2021	3.4
2022	11.6
2023	4.1
2024	1.6
2025*	3.85

## V. Baza ligjore dhe kontraktuale për rinegocimin e kontratës/tarifës

### *Dispozitat kontraktuale*

Neni 23.4 Ndryshimi i Kontratës përcakton: *Të gjitha plotësimet dhe ndryshimet në lidhje me këtë kontratë janë juridikisht të detyrueshme vetëm nëse nuk janë në kundërshtim me ligjin, bëhen me shkrim, janë në pajtim me qëllimet origjinale të kësaj kontrate, nënshkruhen nga përfaqësuesit e autorizuar të paleve si dhe i bashkëngjiten kësaj kontrate.*

Neni i sipërpërmendur i kontratës parashikon një hapësirë të mjaftueshme për rinegocimin dhe rishikimin e dispozitave kontraktuale, kur këto ndërmerren në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe bazohen në marrëveshje të dyanshme, të mbështetur në arsye objektive, siç është rasti i projektit për varrezat. Në këtë kontekst, rregullorja komunale dhe dispozitat ligjore përkatëse ofrojnë një bazë të qëndrueshme për të kërkuar amendimin e tarifave, në përputhje me nivelin e inflacionit dhe humbjet e shkaktuara nga vonesat që nuk lidhen me veprimet apo përgjegjësinë e koncesionarit.

### *Ligjet*

**Ligji Nr. 04/L-045 “Për Partneritet Publiko-Privat”** është akti bazë që rregullon procedurat dhe mekanizmat për hyrjen në PPP dhe krijon një kornizë të qartë për strukturimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e projekteve PPP në Kosovë duke përfshirë:

- Parimet e përgjithshme si transparenca, proporcionaliteti, vlera për paranë dhe përballueshmëria (Neni 4).
- Format kontraktuale dhe institucionale të PPP (Nenet 6–8).
- Procedurat për përzgjedhjen e partnerit privat dhe përmbajtjen e marrëveshjes (Nenet 24–48).
- Rregullat për ndryshime, modifikime dhe ndërprerje të kontratës (Nenet 48–49).

**Neni 9 – Kohëzgjatja e Marrëveshjes** Nëse vonesat institucionale kanë ndikuar në zbatimin e projektit, ky nen lejon **zgjatjen e kontratës deri në 25%** të kohëzgjatjes fillestare, si formë kompensimi indirekt.

*“Kohëzgjatja e marrëveshjes mund të zgjatet deri në një të katërtën e kohëzgjatjes fillestare...”*

**Neni 12 – Ndihma Shtetërore dhe Mbështetja Publike** Lejon që autoriteti publik (p.sh. komuna) të ofrojë mbështetje financiare ose të rregullojë kontributin e saj nëse ka ndikime të jashtme si inflacioni apo vonesat institucionale që cenojnë ekuilibrin ekonomik të projektit.

*“Autoriteti publik mund të ofrojë ndihmë shtetërore në përputhje me legjislacionin në fuqi...”*

Burimi: ASK, 2025

**Inflacioni kumulativ 2017-2025:** Duke kalkuluar efektin kumulativ, përdorim formulën e njohur të zinxhirit për inflacion:

$$I_{\text{total}} = (1+0.015) \times (1+0.011) \times (1+0.027) \times (1+0.002) \times (1+0.034) \times (1+0.116) \times (1+0.041) \times (1+0.016) \times (1+0.02) \times (1+0.038) - 1.$$

Kjo jep një inflacion kumulativ rreth **30.6%** për periudhën në fjalë.

#### *Impaktet konkrete në PPP-në e varrezave në Landovicë*

Kjo rritje e inflacionit ka rrënuar vlerën reale të të ardhurave të parashikuara për koncesionarin dhe, pa mekanizma fleksibël indeksimi, krijon paqëndrueshmëri në operimin financiar të projektit. Çmimet e mallrave të ndërtimit, pajisjeve të mirëmbajtjes, energjisë, fuqisë punëtore dhe materialeve përcjellëse janë adaptuar sipas këtij trendi, duke rritur ndjeshëm koston operacionale të shërbimit të varrezave.

Për pasojë, mos-indeksimi i tarifës bazë për 8 vite vonesë nënkupton një **humbje reale** të të ardhurave për koncesionarin që duhet të kompensohet me përditësimin dhe rinegociimin e tarifave fillestare të përcaktuara në kontratë, sipas indeksit të përgjithshëm të çmimeve të konsumit të llogaritur nga ASK/BQK<sup>46</sup>.

#### **IV. Pasojat financiare për koncesionarin nga vonesat dhe inflacioni**

##### *Analizë e humbjeve të shkaktuara*

Humbjet e shkaktuara nga vonesat përfshijnë një spektr të gjerë të komponentëve financiarë:

- **Humbja e të ardhurave të parealizuara:** Për çdo vit vonesë, koncesionari ka humbur të ardhurat nga tarifa bazë e shërbimit dhe kontributi vjetor komunal.
- **Kosto shtesë të kapitalit të bllokuar dhe mobilizimit të stafit:** Koncesionari ka pasur shpenzime paraprake për planifikim, ekspertizë, ruajtje të pajisjeve dhe mirëmbajtje të përhershme të lokacionit.
- **Kosto të financimit për zvarritje të cashflow-ut të projektit:** Mungesa e kapitalit qarkullues dhe pagesa të papërfituara ndikon në paaftësinë për të përballuar koston e borxhit apo humbje interesi.
- **Humbja e vlerës reale të të ardhurave:** Vlera reale e tarifës së dakorduar në vitin 2017 është zhvlerësuar për rreth 30% si rrjedhojë e inflacionit të grumbulluar.
- **Kosto të operimit të përhershëm, ruajtje të ambientit dhe sigurisë së territorit:** Në shumë raste, duke qenë se ambienti duhet të jetë i mirëmbajtur dhe i mbrojtur nga ndotjet apo dëmtimet, edhe pse nuk ka gjeneruar të ardhura.

Një analizë e detajuar mbi humbjet financiare të shkaktuara nga vonesat do të paraqitet e veçantë.

**Neni 17 – Kompetencat e Komisionit për PPP (KPPP)** KPPP ka kompetencë të miratojë ndryshime në marrëveshje, përfshirë ato që lidhen me tarifatat, nëse ato janë të justifikuara dhe në përputhje me interesin publik.

*“Komisioni për PPP miraton çdo ndryshim të marrëveshjes për PPP...”*

**Neni 48 – Përmbajtja e Marrëveshjes për PPP** Ky nen kërkon që marrëveshja të përfshijë mekanizma për **ndryshimin, modifikimin dhe rishikimin** e kushteve kontraktuale, përfshirë tarifatat dhe kontributet financiare. Kjo dispozitë krijon bazën për amendime të tarifave në rast të ndryshimeve ekonomike ose institucionale.

*“Marrëveshja për PPP duhet të përmbajë dispozita që rregullojnë procedurat për ndryshimin dhe modifikimin e saj...”*

Në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-045 për Partneritetin Publiko-Privat, kontrata PPP mund të rishikohet dhe modifikohet në mënyrë të ligjshme kur ekzistojnë arsye objektive dhe marrëveshje të dyanshme ndërmjet palëve. Sipas nenit 48, marrëveshja duhet të përmbajë dispozita që rregullojnë procedurat për ndryshimin dhe modifikimin e kushteve kontraktuale, përfshirë tarifatat e shërbimit dhe kontributin e komunës. Neni 17 autorizon Komisionin për PPP (KPPP) të miratojë çdo ndryshim të marrëveshjes, duke siguruar që modifikimet të jenë në përputhje me interesin publik dhe vlerën për paranë. Gjithashtu, neni 12 lejon mbështetje financiare nga autoriteti publik në rast të ndikimeve të jashtme si inflacioni apo vonesat institucionale, ndërsa neni 9 parashikon mundësinë e zgjatjes së kontratës deri në 25% të kohëzgjatjes fillestare, si formë kompensimi për humbjet e shkaktuara nga faktorë të pavarur nga koncesionari. Këto dispozita ofrojnë një bazë të plotë ligjore për të kërkuar amendimin e tarifave dhe rishikimin e kontributit komunal në mënyrë të strukturuar dhe të justifikuar.

**Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve** përfaqëson kornizën themelore për marrëdhëniet kontraktuale në Republikën e Kosovës dhe ofron parime të rëndësishme për interpretimin dhe zbatimin e kontratave, përfshirë ato të natyrës publiko-private. Në kontekstin e një kontrate PPP, ky ligj mbështet rishikimin e tarifave dhe kontributit komunal në rast të ndryshimeve të jashtëzakonshme që cenojnë ekuilibrin ekonomik të marrëveshjes.

Kontratat janë të detyrueshme për palët (pacta sunt servanda), por kur rrethanat ndryshojnë në mënyrë të jashtëzakonshme dhe të paparashikueshme, palët kanë të drejtë të kërkojnë rinegociim ose rishikim të kushteve. Ky parim është veçanërisht i zbatueshëm në rastet e inflacionit të lartë, vonesave institucionale, apo ndryshimeve në rregulloret komunale që ndikojnë në kostot e projektit.

Palët janë të detyruara të veprojnë me mirëbesim gjatë zbatimit të kontratës. Kjo nënkupton që autoriteti publik nuk mund të refuzojë pa arsye objektive një kërkesë për rishikim tarifash, kur ekziston dokumentim i qartë për humbje financiare të shkaktuara nga faktorë të jashtëm.

Nëse një palë pëson humbje financiare si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të palës tjetër — për shembull, vonesa në zbatimin e detyrimeve nga komuna — ajo ka të drejtë të kërkojë

kompensim. Ky parim mbështet amendimin e tarifave nëse koncesionari ka pësuar humbje të matshme për shkak të faktorëve të pavarur nga veprimet e tij.

**Si përfundim:** Dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve ofrojnë një bazë të qëndrueshme për të kërkuar rishikimin e tarifave dhe kontributit komunal në kontratat PPP, duke garantuar proporcionalitet, ekuilibër ekonomik dhe zbatim të ndershëm të marrëveshjes. Ky seksion plotëson analizën e bazuar në Ligjin për PPP dhe forcon argumentin për amendimin e kushteve financiare në mënyrë të ligjshme dhe të arsyetuar.

**Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik** rregullon procedurat për lidhjen, zbatimin dhe ndryshimin e kontratave publike, përfshirë edhe ato që lidhen me partneritetet publiko-private kur zbatohen përmes formës kontraktuale. Ky ligj lejon ndryshimin e kontratës gjatë zbatimit të saj, nëse kjo është parashikuar në klauzolat kontraktuale ose është e domosdoshme për shkak të rrethanave të paparashikuara (neni 72). Neni 73 përcakton kufizimet për ndryshime që nuk kërkojnë procedurë të re prokurimi, duke ruajtur natyrën e kontratës dhe përmasat financiare.

Parimet e përbalueshmërisë dhe vlerës për paranë (neni 6), si dhe detyrimi për zbatim me mirëbesim (neni 5), obligojnë autoritetin publik të shqyrtojë amendimin e tarifave kur ka dokumentim të humbjeve të shkaktuara nga faktorë të jashtëm. Po ashtu, neni 35 kërkon që kontrata të përmbajë klauzola të qarta për ndryshime të mundshme, përfshirë tarifat dhe kontributet.

Këto dispozita ofrojnë bazë të qëndrueshme për rishikimin e kushteve financiare në kontratat PPP, në përputhje me zhvillimet ekonomike dhe interesin publik.

## **VI. Kalkulimi i tarifës së re të propozuar dhe mekanizmi i indeksimit vjetor**

### *Metodologjia e llogaritjes*

Për të arritur në një tarifë të re të qëndrueshme dhe të drejtë, bazohemi në këto parime:

- Tarifa fillestare bazohet në nivelin e rënë dakord në kontratë, indeksohet me inflacionin kumulativ të periudhës.
- Çdo vit në vijim, tarifa vjetore i nënshtrohet indeksimit automatik sipas IHÇK-së (Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit) për Kosovën, i publikuar nga ASK.
- Tarifat duhet të plotësojnë mbulimin e shpenzimeve aktuale të operimit, investimit dhe mirëmbajtjes sipas standardeve të rregullores dhe kontratës.
- Llogaritja e tarifës duhet të bazohet edhe në vendimin nr. 10/273 të Qeverisë për pagën minimale prej vitit 2026.

## VII. Analiza dhe propozimi për kontributin vjetor të Komunës (Indeksim me inflacionin)

Kontributi vjetor i Komunës ka qenë i përcaktuar në vlerën 50,000€. Në të njëjtën mënyrë si tarifa e varrimit, edhe ky kontribut duhet të indeksohet sipas normës kumulative të inflacionit për periudhën 2017-2025, domethënë:

- Kontributi fillestar: 50,000€
- Inflacioni kumulativ (30.6%):  $50,000€ \times 1.306 = 65,300.00€$

Nga viti 2026 e tutje, kontributi i komunës propozohet të indeksohet ne baza vjetore në të njëjtën mënyrë si tarifat e varrimit, në përputhje të plotë me klauzolat kontraktuale, rregullore komunale dhe standardet ndërkombëtare të PPP-ve.

Ky propozim siguron ruajtjen e vlerës reale të kontributit dhe mundëson që projektin t'i ruhet qëndrueshmëria financiare, pa cenuar cilësinë apo gamën e shërbimeve të ofruara për qytetarët<sup>9</sup>.

## VIII. Përmbledhje e analizës: tabela krahasuese

Komponenti	Vlera Fillestare (2017)	Inflacioni Kumulativ(%)	Përqindja e rritjes bazuar në pagën minimale	Vlera e re e Propozuar (2026)
Kontributi vjetor i Komunës	50,000€	30.6%	-----	65,300.00€
Mekanizmi indeksimit	---	---		IHÇK për çdo vit

Në vitin 2017 paga minimale në Kosovë ka qenë 170 €. Në paramasën e dorëzuar së bashku me planin e biznesit, paga minimale është paraqitur në vlerë prej 250 €. Kalkulimi i paraqitur në tabelë është bërë duke u bazuar në ndryshimet e pagës minimale ndër vite, duke marrë parasysh rritjen e saj graduale deri në nivelin aktual.

Për këtë arsye, vlerat në tabelë reflektojnë përditësimin e kostove sipas rritjes së pagës minimale. Po ashtu, në bazë të tabelës dhe rritjes së pagës minimale, është bërë edhe rregullimi i pagave të punëtorëve në paramasë. Ky ndryshim është reflektuar duke u bazuar në vendimin e Qeverisë të muajit tetor 2025, i cili obligon përshtatjen e pagave sipas nivelit të ri të pagës minimale prej vitit 2026.

	Paga minimale 2017	Dallimi në përqindje	Paga	Paga minimale 2023	%	Paga	Paga minimale 2024	%	Paga	Paga minimale (Janar – Qershor) 2026	%	Paga	Paga minimale 2026	%	Paga
	2017			2023			2024			2025			2026		
1	170.0	135%	400.0	264.0	135%	620.40	350.0	135%	822.50	425.0	135%	998.75	500.0	135%	1,175.00
2	170.0	124%	380.0	264.0	124%	591.36	350.0	124%	784.00	425.0	124%	952.00	500.0	124%	1,120.00
3	170.0	106%	350.0	264.0	106%	543.84	350.0	106%	721.00	425.0	106%	875.50	500.0	106%	1,030.00
4	170.0	76%	300.0	264.0	76%	464.64	350.0	76%	616.00	425.0	76%	748.00	500.0	76%	880.00
5	170.0	62%	275.0	264.0	62%	427.68	350.0	62%	567.00	425.0	62%	688.50	500.0	62%	810.00
6	170.0	47%	250.0	264.0	47%	388.08	350.0	47%	514.50	425.0	47%	624.75	500.0	47%	735.00

Në bazë të llogaritjeve ndër vite, është vlerësuar se edhe çmimi në paramasë duhet të ndryshohet, duke kalkuluar shërbimet mbi bazën e inflacionit si dhe pagat e punëtorëve për menaxhimin e varrezave në përputhje me rritjen e pagës minimale. Si rezultat i këtyre kalkulimeve, propozohet që çmimi për një varrim të jetë në vlerën **406.76 €**

## **IX. Rekomandime për procedurën dhe dialogun institucional**

Duke marrë parasysh kontributin konstruktiv të Komunës së Prizrenit në rikthimin e projektit dhe dëshirën për një finalizim të suksesshëm, koncesionari kërkon fillimin e dialogut zyrtar për rinegocimin e tarifave, duke ofruar transparencë të plotë për kalkulimet dhe burimet.

Në këtë mënyrë synohet të sigurohet një proces gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm sipas standardeve të qeverisjes së mirë dhe praktikave të mira të PPP-ve në rajon dhe në BE.

## **X. Përfundim**

Rekomandimi për rinegocimin e tarifave dhe përditësimin e kontributit të komunës, në raport me inflacionin dhe humbjet reale të shkaktuara nga vonesat institucionale, është jo vetëm një zgjidhje financiare optimale për koncesionarin, por edhe një detyrim ligjor, moral dhe institucional ndaj qytetarëve, për të siguruar shërbime të standardit të lartë dhe transparencë të plotë financiare. Ky hap forcon partneritetin publik-privat, respekton ligjin, ndihmon në menaxhimin e riskut të projektit PPP dhe vendos bazën për një projekt të suksesshëm dhe të qëndrueshëm për periudhen vijuese.

**Paramasat për kalkulimin e vlerës për varrim sipas rritjes së inflacionit në vitet 2017-2025 (30.6%) në shërbime dhe sipas rritjes së pagës minimale tek punëtorët për menaxhimin e varrezave**

<b>Përshkrimi i punëve për planifikim, mirëmbajtje, pastrime, rregullime tereni, shpenzime të ndryshme</b>					
<b>Pershkrimi i puneve</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi</b>	<b>Vlera</b>	
1 Planifikimi i terrenit (pastrim, nivelizim) me makineri te nevojshme si dhe mjetet e punës për mirëmbajtjen e hapësirës së varrezave, kositja, krasitja, ujitja dhe pastrimi, afërsisht 57 ha.	m <sup>2</sup>	570,000.00	0.07	39,900.00	
2 Hargjimet e ujit dhe kanalizimit	muaj	12	261.20	3,134.40	
3 Hargjimet e rrymës elektrike	muaj	12	600.76	7,209.12	
4 Transporti i punëtorëve nga qyteti dhe anasjelltas.	muaj	12	163.25	1,959.00	
			A	52,202.52	
<b>Numri i punëtorëve të nevojshëm për menaxhimin e varrezave të reja të qytetit.</b>					
	<b>Vendi i punes - shkollimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Numri punetoreve</b>	<b>Pagesa mujore</b>	
1	Përgjegjësi - Menagjeri me fakultet 1 x 400	muaj	12	1175.0	14,100.00
2	Administrator- ekonomisti me fakultet 1 x 380	muaj	12	1120.0	13,440.00
3	Administrator fakultet e mesme 1 x 380	muaj	12	1120.0	13,440.00
4	Punëtorë fizikë fillore- mesme 4 x 300	muaj	12	3520.0	42,240.00
5	Operator makinash 2 x 350	muaj	12	2060.0	24,720.00
6	Mjeshtër i përgjithshëm (elektrik, ujesjelles -kanalizim, zdrukhtare, etj. )( fillore- mesme ) 1 x 300	muaj	12	880.0	10,560.00
7	Roje ( fillore- mesme ) 3 x 250	muaj	12	2205.0	26,460.00
8	Mirëmbajtja e objektit administrative ( fillore- mesme ) 1 x 250	muaj	12	735.0	8,820.00
9	Punëtor për mirëmbajtje të hapësirës gjelberuese. 2 x 275	muaj	12	1620.0	19,440.00
			<b>108</b>	<b>B</b>	<b>173,220.00 €</b>
				A+B	<b>225,422.52 €</b>
				1,095.00	<b>205.87 €</b>

<b>B</b>	<b>Pershkrimi i puneve për një varr - vlera</b>				
<b>Pershkrimi i puneve</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi</b>	<b>Vlera</b>	
1	Gërmimi, hapja si dhe mbyllja dhe përgaditja e varrit me dimensione 2.1x1x1.1m	m <sup>3</sup>	2.50	32.65	81.63
2	Materiali harxhues për mbulim- derrasa t= 5 cm, dimensione mesatare 1.5x2.1 m, 3.05 m <sup>2</sup> .	m <sup>3</sup>	0.16	391.80	62.69
3	Materiali harxhues për hidroizolim- letra e zezë, kondori 3- 4 mm, me dim. 2.0x2.5 m	m <sup>2</sup>	5.00	3.92	19.60
				<b>Vlera totale :</b>	<b>163.91 €</b>
				1,095.00	<b>179,484.74 €</b>

404,907.26 €

	<b>369.78 €</b>
10%	<b>36.98 €</b>
<b>Totali :</b>	<b>406.76 €</b>



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 10/273  
Datë: 31.10.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 57 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-142 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përcaktojnë Shumën e Beneficionit në Lartësi të Pagës Minimale, Procedurat e Caktimit të Pagës Minimale dhe Shkallët Tatimore në të Ardhurat Personale Vjetore, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 tetor 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet propozimi i Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për përcaktimin e pagës minimale në Republikën e Kosovës, si vijon:
  - 1.1. Duke filluar nga data 1 janar 2026, në nivelin prej 2.50€ (dy euro e pesëdhjetë centë) për një orë pune të rregullt, apo ekuivalent me 425.00€ (katërqind e njëzet e pesë euro) bruto në muaj për punë me orar të plotë.
  - 1.2. Duke filluar nga data 1 korrik 2026, në nivelin prej 3.00€ (tre euro) për një orë pune të rregullt, apo ekuivalent me 500.00€ (pesëqind euro) bruto në muaj për punë me orar të plotë.
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Inspektorati i Punës për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

*PEA*  
  
Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





Formulari per kerkese apo ankese

Drejtorati/Njesia

Data 09/03/2026

Drejtoria për Shërbime Publike

Mos shkruani në këtë pjesë

1. Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:

Emri dhe mbiemri

Numri personal

PZ Group SHPK

71337685

Adresa e vendbanimit

E-mail Adresa

Remzi Ademaj nr.34

Numri i tel. fiks

Numri i tel. mobil

044/116-450

00000000

2. Mënyra e pranimit

Statusi i lëndës

Kërkesa

Ne proces

Vlera për pagesë: 0.00

Numri i protokolit

05-352/05-0028397/26

Afati i zgjedhjes

08/04/2026

Vendimi

3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

Plotesim i kerkeses per ..... 05-352-130-414

4. Dokumentet e bashkangjitura:

Nr. Lloji i dokumentit


5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Unë PZ Group SHPK vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Nënshkrimi)

\*Ju lutemi të kërkonti nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura

Pranuar nga: kastriote.vata



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Nr. 001/011 - 70340

Më: 03 qershor 2025

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren - Prizren Belediyesi

HYRËSE - ULAZIMA - INCOMING		
REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO		
DREJTORIA E DREJTORISË PËR QYLLIMET E QYLLIMET		
Ministria e Administratës të Përcaktimit Lokal		
Ministry of Local Government Administration		
Data: 10.06.2025		
Ehron:		
Dite:		
Hyri/çikimi/izlaz:	Nr. i shtetit:	Vite:
-VI-	0-374	

### RREGULLORE 02/2025

## PËR VARRIM DHE MIRËMBAJTJEN E VARREZAVE TË REJA TË PRIZRENIT NË LANDOVICË

Prizren,

qershor, 2025

## Përmbajtja

KREU I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME .....	3
Preambula.....	3
Neni 1 - Qëllimi .....	3
Neni 2 - Përkufizime .....	4
KREU II: PRONËSIA DHE PËRGJEGJËSITË E PALËVE .....	5
Neni 3 - Pronësia e Lokacionit.....	5
Neni 4 - Shërbimet dhe Mirëmbajtja.....	6
Neni 5 - Detyrat e Komunës.....	7
Neni 6 - Detyrat e Koncesionarit.....	7
KREU III: ORGANIZIMI I HAPËSIRËS SË VARREZAVE, DIMENSIONET E VARREVE DHELAPIDAREVE .....	8
Neni 7 - Plani i varrezave dhe ndarja e hapësirave.....	8
Neni 8 - Dimensionet e Varreve.....	9
Neni 9 - Standardizimi i lapidarëve.....	9
KREU IV: PRAKTIKAT DHE PROCEDURAT E VARRIMIT .....	10
Neni 10 - Procedurat dhe Kushtet e Varrimit.....	10
Neni 11 - Bartja e Kufomës .....	11
Neni 12 - Lejet për Zhvarrosje dhe Relokim.....	11
Neni 13 - Kremimi i Kufomave .....	11
KREU V: SJELLJA NË VARREZA DHE MASAT NDAJ SHKELJEVE.....	12
Neni 14 - Sjelljet gjatë varrimit.....	12
Neni 15 - Sjellja e Vizitorëve në Varreza .....	12
Neni 16 - Masat ndëshkuese.....	13
KREU VI: TARI FAT DHE ARKËTIMI I TË ARDHURAVE.....	14
Neni 17 - Çaktimi dhe Arkëtimi i Tarifave .....	14
KREU VII: STANDARDET E MIRËMBAJTJES DHE INSPEKTIMI .....	16
Neni 18 - Standardet e Mirëmbajtjes dhe Operimit .....	16
Neni 19 - Inspektimi dhe Monitorimi nga Komuna .....	17
KREU VIII: ZBATIMI DHE DISPOZITAT PËRFUNDIMTAR .....	17
Neni 20 - Mbikëqyrja .....	17
Neni 21 - Përgjegjësitë Ligjore të Palëve.....	18
Neni 22 - Harmonizimi me Ligjet dhe Rregulloret Lokale .....	18
Neni 23 - Dispozitat Përfundimtare .....	19
Neni 24 - Hyrja në Fuqi .....	19
Shtojca 1. Plani i tarifave për shërbimet e varrimit dhe mirëmbajtjes së varrezave .....	20
Shtojca 2. Detajet rreth përmasave të varreve.....	21

## KREU I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Preambula

Komuna e Prizrenit, duke u bazuar në kompetencat e saj sipas nenit 12 paragrafi 12.2 (c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe marrëveshjes së koncesionit për partneritet publiko-privat, miraton këtë rregullore me qëllim të rregullimit, mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të varrezave në lokacionin e përcaktuar me kontratën koncesionit: Partneriteti Publiko Privat, Varrezat e Reja në Fshatin Landovicë të Prizrenit (Kontrata), me numër të prokurimi publik: PPP-16-085-611, duke garantuar respektimin e standardeve mjedisore dhe ligjore për të siguruar një shërbim cilësor për qytetarët.

### Neni 1 - Qëllimi

Kjo rregullore përcakton kushtet, parimet dhe standardet për organizimin, rregullimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e varrezave në territorin e Komunës së Prizrenit. Dokumenti është hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe dispozitat e Kontratës në fjalë.

#### 1.1. Qëllimi i Rregullores

Qëllimi kryesor i kësaj rregulloreje është:

1. Sigurimi i një infrastrukture të qëndrueshme për varrezat, që garanton hapësira të organizuara dhe të menaxhuara në përputhje me standardet më të larta.
2. Ofrimi i shërbimeve cilësore për qytetarët, përfshirë shërbimet e varrimit, mirëmbajtjen e varrezave dhe organizimin e hapësirave për përkujtime dhe ceremonial, si dhe shërbimet e ndërlidhura,
3. Mbrojtja e mjedisit dhe ruajtja e integritetit urbanistik përmes menaxhimit të qëndrueshëm të varrezave dhe zvogëlimit të ndikimit mjedisor,
4. Mbështetja e qytetarëve me shërbime shtesë, përfshirë kujdesin për hapësirat përkujtimore dhe ofrimin e kushteve për kryerjen e ceremonive fetare dhe tradicionale.

#### 1.2. Objektivat Kryesore

##### 1. Menaxhimi Efikas i Varrezave:

- o Përcaktimi i detyrimeve të Komunës dhe të Koncesionarit në lidhje me ndërtimin, operimin dhe administrimin e varrezave.
- o Implementimi i praktikave të mira për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e vazhdueshëm të varrezave.

##### 2. Transparenca dhe Mbledhja e Tarifave:

- o Vendosija e një sistemi të qartë dhe të drejtë për mbledhjen e tarifave për shërbimet e varrimit.

- Sigurimi që të ardhurat nga tarifat të përdoren ekskluzivisht për përmirësimin e infrastrukturës dhe për ofrimin e shërbimeve të tjera, në pajtim me kontratën e koncesionit.

### 3. Respektimi i Ligjeve dhe standardeve të aplikueshme:

- Harmonizimi i rregullave të kësaj rregulloreje me kërkesat ligjore dhe standardet e përcaktuara nga kontrata e koncesionit.
- Sigurimi që të gjitha proceset të jenë në përputhje me ligjet dhe rregulloret për mbrojtjen e mjedisit, të drejtave të njeriut dhe të trashëgimisë kulturore.

## 1.3. Fusha e Zbatimit

Kjo rregullore zbatohet nga:

### 1. Komuna e Prizrenit, që ka përgjegjësinë për:

- Miratimin dhe mbikëqyrjen e implementimit të kësaj rregulloreje,
- Inspektimin e zbatimit të standardeve të përcaktuara në kontratën e koncesionit,
- Zhvillimin dhe miratimin e të gjitha planeve urbanistike dhe të ngjashme të nevojshme për ndërtimin dhe zgjerimin e varrezave.

### 2. Koncesionari, që ka përgjegjësinë për:

- Menaxhimin dhe mirëmbajtjen e përditshme të varrezave,
- Sigurimin e shërbimeve të varrimit në përputhje me standardet dhe tarifat e miratuara,
- Kryerjen e investimeve për përmirësimin e infrastrukturës dhe ofrimin e shërbimeve shtesë për qytetarët,
- Ofrimin e shërbimeve të tjera në përputhje me Kontratën e Koncesionit.

## 1.4. Parimet e Zbatimit

### 1. Përgjegjësitë e Përbashkëta:

- Komuna dhe Koncesionari janë të detyruar të bashkëpunojnë për zbatimin e rregullores, duke respektuar standardet teknike, kërkesat ligjore dhe kontratën e koncesionit,
- Përbushja e detyrimeve në kohë dhe me cilësi të lartë për të garantuar shërbime të qëndrueshme për qytetarët.

### 2. Respektimi i Dinjitetit dhe Kulturës:

- Respektimi i traditave dhe zakoneve fetare dhe kulturore të qytetarëve gjatë ofrimit të shërbimeve të varrimit,
- Sigurimi i qetësisë dhe dinjitetit në hapësirat e varrezave për të gjitha komunitetet.

### 3. Menaxhimi i Transparencës:

- Sigurimi i informacionit të qartë dhe të aksesueshëm për qytetarët në lidhje me shërbimet dhe tarifat e varrimit,
- Publikimi i raporteve periodike për të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me varrezat.

## Neni 2 - Përkufizime

**Bashkësi Fetare (BF):** Organizatat fetare (Bashkësia Islame, Komuniteti Katolik, Ortodoks, etj.) të cilat organizojnë ceremoni varrimi sipas riteve të tyre.

**DSHP:** Drejtoria e Shërbimeve Publike,

**Koha e prehjes:** Periudha minimale gjatë së cilës nuk lejohet zhvarrimi i zakonshëm,

**Komuna:** Komuna e Prizrenit, autoriteti kontraktues dhe mbikëqyrës i zbatimit të kësaj Rregulloreje dhe Kontratës.

**Koncesionar:** Subjekti i përzgjedhur sipas Ligjit Nr0/L-0 për Partneritetet Publiko-Private, i cili ka marrë të drejtën për të menaxhuar varrezat për periudhën e përcaktuar në kontratë,

**Kontrata e Koncesionit:** Partneriteti Publiko Privat, Varrezat e Reja në Fshatin Landovicë të Prizrenit, me numër të prokurimit publik: PPP-16-085-611,

**Kufome:** trupi i njeriut, i privuar nga funksionet jetësore,

**Lapidar (Monument varri):** Pllakë ose gur përkujtimor mbi varr me të dhënat e të ndjerit. **Lapidar standard** është modeli i unifikuar i monumentit të varrit (përmasa, material dhe formë e njëjtë) i aprovuar nga Komuna për t'u përdorur në këtë varrezë.

**MAPL:** Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,

**MFPT:** Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve,

**PPP:** partneritet publiko privat sipas përkufizimit në Ligjin për Partneritet Publiko Privat, Ligji Nr. 04/L-045,

**Shërbim i varrimit:** veprimtaria që zhvillohet nga subjektet publike ose private, nga rasti i vdekjes deri në varrimin e kufomës,

**Varr:** gropën e gërmuar në tokë për trupin e të ndjerit ose mbetjet mortore,

**Varrezë:** nënkupton vendin/hapësirën ku varrosen të vdekurit ose mbetjet mortore, e cila përfshinë anën e brendshme (hapësira për të futur kufomat e të vdekurve ose mbetjet e tyre mortore dhe hapësira tjetër përcjellëse) dhe anën e jashtme e cila përfshinë hapësira qarkulluese, e parkimit dhe e shërbimeve tjera,

**Varrim:** nënkupton ceremoninë e përcjelljes të vdekurit për në varr,

**Varrmihës:** nënkupton punëtorin që hap varre në varreza,

**Vend-varreze:** parcela e caktuar brenda varrezës për një varr ose një grup varresh familjare,

**Zhvarrim:** është nxjerrja e kufomës dhe/ose mbetjeve mortore nga varri,

**Zhvarrim i zakonshëm:** është zhvarim që kryhet pas përfundimit të kohës së prehjes,

**Zhvarrim i jashtëzakonshëm:** është zhvarim që kryhet para përfundimit të kohës së prehjes, sipas procedurave ligjore, për ekspertizë kriminalistike, për arsye transferimi në një varr tjetër, pas një periudhe të paracaktuar kohe ose për interes publik.

## **KREU II: PRONËSIA DHE PËRGJEGJËSITË E PALËVE**

### **Neni 3 - Pronësia e Lokacionit**

Sipas nenit 2.2 të Kontratës së Koncesionit, varrezat dhe objektet e patundshmërisë të ndërtuara nga koncesionari në vendndodhje janë dhe mbeten pronë komunale, me të drejtën ekskluzive

të pronësisë nga Komuna. Koncesionari nuk mund të litojë pronësinë, por gëzon të drejtën e shfrytëzimit për periudhën e vlefshmërisë së kontratës.

Të gjitha objektet e ndërtuara nga Koncesionari në lokacion mbeten pronë e Komunës, dhe pas përfundimit të kontratës ose në rast të shkëputjes së saj, ato i rikthehen automatikisht Komunës pa asnjë detyrim shtesë. Kjo garanton që pronësia dhe kontrolli i infrastrukturës dhe lokacionit të mbeten pasuri publike.

## **Neni 4 - Shërbimet dhe Mirëmbajtja**

### **4.1. Rregullimi i Varrezave**

Koncesionari është përgjegjës për mirëmbajtjen e gjelbërimit, rrugëve dhe infrastrukturës brenda varrezave, duke përfshirë objektet për kryerjen e shërbimeve të varrimit (si ujëmbledhësit dhe hapësirat sanitare dhe të tjera).

### **4.2. Mirëmbajtja e varrezave**

1. Koncesionari administron me punët e varrimit, të rregullimit dhe mirëmbajtës së varreve në këto varreza.
2. Rregullimin e varrit mund ta bëjnë edhe anëtarët e familjes së të vdekurit sipas kushteve të kësaj Rregulloreje.
3. Të gjitha varret dhe varrezat do të trajtohen me pietet dhe dinjitet nga komuna, duke respektuar të gjitha konfesionet fetare ose dëshirat e anëtarëve të familjes.
4. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, anëtarët e të gjitha feve dhe qytetaret jo-religjioz do të kenë qasje të barabartë në ofrimin e shërbimeve komunale, sipas kushteve të parapara me këtë Rregullore.

### **4.3. Emergjencat dhe Përgjegjësitë e Koncesionarit për Mbrojtjen e Mjedisit**

Koncesionari ka për detyrë të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të mbrojtur mjedisin dhe për të minimizuar ndikimet negative gjatë ofrimit të shërbimeve. Ai duhet të zbatojë masa konkrete për menaxhimin e mbetjeve, reduktimin e zhurmës dhe ndotjes, si dhe për të parandaluar dëmet ndaj tokës, ujit dhe ajrit. Përveç kësaj, Koncesionari është përgjegjës për planifikimin dhe zbatimin e masave të emergjencës për të siguruar sigurinë e personelit dhe mbrojtjen e ambientit në rastet e emergjencave natyrore apo aksidenteve. Në raste të tilla, Koncesionari duhet të veprojë menjëherë, të informojë autoritetet përkatëse dhe të koordinojë veprimet për minimizimin e dëmeve dhe rikthimin e gjendjes normale.

Gjithashtu, Koncesionari ka detyrimin të raportojë të gjitha emergjencat dhe masat e ndërmarra, duke mbajtur një regjistër të detajuar për inspektim nga Komuna dhe autoritetet mbikëqyrëse. Këto detyrime sigurojnë që aktivitetet e tij të kryhen në përputhje me standardet mjedisore dhe të drejtat e komunitetit, duke garantuar që çdo ndikim negativ të minimizohet dhe mjedisi të mbrohet në mënyrë të qëndrueshme.

## **Neni 5 - Detyrat e Komunës**

Në përputhje me Kontratën e Koncesionit dhe ligjin në fuqi, Komuna ka përgjegjësi të sigurojë që varrezat të operojnë në përputhje me standardet ligjore dhe mjedisore. Detyrat e Komunës përfshijnë, por nuk kufizohen në:

### **5.1. Sigurimi i Rendit dhe Posedimit të Qetë të Lokacionit**

Të bashkëpunojë me organet e rendit për të garantuar sigurinë publike në varreza. T'i ofrojë Koncesionarit, sipas Nenit 6.3 të Kontratës së Koncesionit, përpara fillimit të punimeve ndërtimore si dhe gjatë gjithë periudhës së koncesionit posedim të qetë të lokacionit, pa pengesa nga palët e trata. Komuna duhet të sigurojë që të gjitha çështjet juridike dhe administrative në lidhje me pronësinë dhe përdorimin e lokacionit të jenë të zgjidhura dhe që nuk ka pengesa nga palët e trata.

### **5.2. Mbështetje Administrative dhe Lejet e Nevojshme:**

Komuna është e obliguar të sigurojë mbështetje administrative gjatë gjithë periudhës së implementimit të projektit, duke përfshirë dhënien e lejeve të nevojshme për ndërtimin dhe operimin e varrezave. Komuna gjithashtu duhet të sigurojë që të gjitha licencat dhe miratimet përkatëse janë të lëshuara për koncesionarin për të siguruar funksionimin pa probleme të projektit.

### **5.3. Mbikëqyrje dhe Monitorim**

Komuna ka përgjegjësinë për të monitoruar zbatimin e kontratës nga koncesionari, përfshirë inspektimet e rregullta të punimeve dhe shërbimeve të ofruara. Komuna do të sigurojë që standardet e përcaktuara për cilësinë e shërbimeve dhe mirëmbajtjen e varrezave të respektohen gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

### **5.4. Inspektimi**

Komuna do të inspektojë periodikisht varrezat për të siguruar përputhjen me këtë rregullore dhe kontratën e koncesionit.

### **5.5. Mbështetje financiare (kur aplikohet)**

Në rastet e përcaktuara me vendim të veçantë, Komuna do të subvencionojë ose mbulojë shpenzimet e varrimit për qytetarët e saj, konform politikave komunale.

## **Neni 6 - Detyrat e Koncesionarit**

Koncesionari ka detyrime të caktuara për t'u përmbushur gjatë periudhës së zbatimit të projektit dhe menaxhimit të varrezave. Detyrat kryesore të koncesionarit janë:

### **6.1. Implementimi i Projektit**

Koncesionari është përgjegjës për financimin dhe realizimin e projektit, duke përfshirë ndërtimin, instalimin, dhe operimin e varrezave. Kjo përfshin sigurimin e të gjitha burimeve të nevojshme financiare dhe teknike për përmbushjen e kërkesave të kontratës.

### **6.2. Sigurimi i Dokumenteve të Nevojshme**

Koncesionari duhet të dorëzojë dokumentet themelore për zbatimin e projektit, përfshirë planin financiar, planin ndërtimor dhe raportin e vlerësimit mjedisor. Gjithashtu, duhet të sigurojë një raport të detajuar për çdo ndryshim të mundshëm që mund të ndikojë në implementimin e projektit.

### **6.3. Mbledhja e Tarifave dhe Arkëtimi**

Koncesionari ka të drejtë të mbledhë tarifën për shërbimet e varrimit dhe shërbimet e tjera shtesë, duke i ndihmuar në financimin e operacioneve të përditshme. Tarifën duhet të jenë të përballueshme për qytetarët dhe të mbështeten nga një analizë e detajuar e kostove të shërbimeve.

### **6.4. Operimi, Mirëmbajtja dhe Siguria e Infrastrukturës**

Menaxhimi i përditshëm i varrezave, duke përfshirë hapjen dhe mbylljen e varreve, mirëmbajtjen e vazhdueshme të varrezave dhe infrastrukturës së lidhur, duke siguruar që shërbimet ofrohen në nivelin më të lartë të mundshëm të cilësisë dhe në përputhje me standardet teknike dhe mjedisore të përcaktuara në kontratën e koncesionit.

### **6.5. Cilësia e shërbimeve**

Ofrimi i shërbimeve të varrimit me cilësi të lartë dhe me dinjitet, pa diskriminim, duke respektuar ritet fetare sipas dëshirës dhe kërkesave të familjes. Koncesionari siguron që stafi i tij të jetë i trajnuar për t'u sjellë me respekt dhe profesionalizëm ndaj familjarëve të të ndjerit. Gjithashtu, kërkohet nga koncesionari që të koordinohet me përfaqësuesit e autorizuar të bashkësive fetare për aspektet ceremoniale të varrimit.

### **6.6. Mirëmbajtja e Dokumenteve**

Koncesionari duhet të mbajë një regjistër të detajuar të shërbimeve të kryera dhe dokumentacionin e kërkuar për inspektim nga komuna.

### **6.7. Mbrojtja e mjedisit dhe siguria**

Ndërmarrja e masave për mbrojtjen e mjedisit gjatë operimit (menaxhimi i mbetjeve, dezinfektimi periodik, kontrolli i erërave të pakëndshme, etj.) dhe zbatimi i planit emergjent në rast fatkeqësish natyrore apo incidenteve për të siguruar sigurinë e personelit dhe vizitorëve. Çdo incident i jashtëzakonshëm raportohet menjëherë te Komuna dhe institucionet kompetente, duke dokumentuar veprimet e ndërmarra.

## **KREU III: ORGANIZIMI I HAPËSIRËS SË VARREZAVE, DIMENSIONET E VARREVE DHE LAPIDAREVE**

### **Neni 7 – Plani i varrezave dhe ndarja e hapësirave**

- 1. Planifikimi urbanistik:** Varrezat e reja në Landovicë janë planifikuar si kompleks i integruar, i cili përmban fushat e varrimit, rrugët dhe shtigjet e brendshme, zonat e gjelbërimit dhe facilitetet shërbyese (p.sh. kapela mortore, vend-parkimet, zyra administrative). Plani i varrezave duhet të parashikojë nevojat për së paku 100 vitet e

ardhshme, me mundësi zgjerimi fazor nëse paraqitet nevoja, ku ndarja sipas bashkësive fetare do të bëhet në përpjesëtim me nevojat dhe përbërjen demografike, duke iu referuar planit zyrtar të kontratës.

2. **Përbërësit kryesorë të varrezave:** Varreza përbëhet nga:
  - o Radhët e varreve – grupi i varreve të renditura njëpasnjë (deri në ~200 varre për çdo fushë varrimi, të ndara nga një shteg i mesëm)
  - o Fushat e varrezave – disa radhë varresh të kufizuara së bashku, të ndara nga shtigje më të gjera ose hapësira të gjelbërta.
  - o Shtigjet dhe rrugicat – kalimet e këmbësorëve brenda fushave të varrezave. Çdo radhë varri do të ketë një shteg të ngushtë për qasje, ndërsa fushat ndahen me shtigje kryesore më të gjera.
  - o Rrugët e brendshme – rrugë të kalueshme me automjete të vogla ose këmbësorë, që lidhin hyrjen e varrezave me pjesët e ndryshme (p.sh. rrugë rrethore ose kryesore mes seksioneve).
  - o Hapësirat funksionale – përfshijnë hyrjen kryesore (me portal ose derë), vendet e pushimit (stola, hije), pusët e ujit, vendet për hedhjen e mbeturinave, etj.
3. **Sektorët specialë:** Përveç ndarjes sipas komuniteteve fetare (e paraparë në dokumentacionin teknik të kontratës), në planin e varrezave do të përcaktohen sektorë të veçantë për:
  - o **Varret e dëshmorëve dhe heronjve të kombit:** Një zonë e dedikuar ku prehen dëshmorët e luftës dhe heronj të tjerë, e cila do të ketë karakter memorial. Këto varre do të identifikohen veçmas dhe do të mirëmbahen me prioritet nga Komuna në bashkëpunim me Koncesionarin.
  - o **Parcelat familjare:** (Opsionale) nëse ndonjë familje ka të drejtën e një parcele familjare brenda varrezave publike, ajo do të evidentohet si e tillë, por do t'i nënshtrohet rregullave të kësaj Rregulloreje.

## **Neni 8 - Dimensionet e Varreve**

### **8.1. Dimensionet standarde të varreve individuale**

Detajet teknike rreth përmasave të varreve, përfshirë madhësinë dhe thellësinë mund të gjinden në Shtojcën 2 të kësaj rregulloreje.

Monumentet ose pllakat përkujtimore mund të kenë një lartësi maksimale prej **2.00 m**, dhe duhet të përmbajnë vetëm informacionin e nevojshëm (emrin, mbiemrin, datën e lindjes dhe vdekjes), përveç nëse ndryshe përcaktohen përmes akteve të tjera ligjore.

## **Neni 9 – Standardizimi i lapidarëve**

1. **Modeli unik:** Në varrezat e reja të Komunës së Prizrenit zbatohet standardizimi i lapidarëve (monumenteve të varrit) sipas modelit të miratuar nga Komuna. Kjo do të thotë që të gjithë lapidarët e vendosur mbi varre do të kenë dimensione, formë dhe material të njëjtë, në mënyrë që të arrihet një pamje e unifikuar estetike e varrezës.
2. **Karakteristikat e lapidarit standard:** Lapidari standard përbëhet nga një pllakë guri ose betoni e kualitetit të lartë, me ngjyrë neutrale (p.sh. e bardhë a gri e çelur), me lartësi dhe gjerësi të unifikuar (p.sh. 1.0 m i lartë mbi nivelin e tokës dhe 0.5 m i gjerë), i vendosur vertikalisht tek koka e varrit. Secili lapidar do të ketë hapësirë për skalitjen e të dhënave të të ndjerit (emri, mbiemri, datëlindja dhe data/viti i vdekjes) dhe, sipas dëshirës, një simbol

fetar ose dekorim (p.sh. kryq i vogël, gjysmëhënë, yll, etj. me përmasa të vogla të paracaktuara).

3. **Vendosja dhe mirëmbajtja:** Familjarët, në rast se vendosin për lapidar, janë të obliguar të sigurojnë dhe vendosin lapidarin standard brenda një periudhe të shkurtër pas varrimit. Familjarët e të ndjerit mund të zgjedhin opsionin e vendosjes së fotografisë së të ndjerit ose ndonjë mbishkrimi shtesë brenda kornizës së paraparë në lapidarin standard, por nuk lejohen ndryshime në dimension apo formë.
4. **Ndalesa për monumente jostandarde:** Nuk lejohet ndërtimi apo vendosja e përmendoreve private, pllaka apo konstruktive të tjera jostandarde në varreza (si bustë, shtylla, strehëza, gardhe dekorative individuale, etj.), me përjashtim të rasteve kur Komuna jep leje të veçantë (p.sh. për ndonjë figurë të shquar ku parashihet monument publik brenda varrezave). Çdo lapidar apo objekt tjetër i vendosur pa leje do të hiqet nga Koncesionari në konsultim me Komunën.

## **KREU IV: PRAKTIKAT DHE PROCEDURAT E VARRIMIT**

### **Neni 10 - Procedurat dhe Kushtet e Varrimit**

#### **10.1. Konfirmimi i vdekjes**

Konfirmimi i vdekjes është i detyrueshëm dhe duhet të bëhet nga një mjek i autorizuar ose Instituti i Mjekësisë Ligjore, sipas legjislacionit në fuqi.

#### **10.2. Koha e varrimit**

- Familjarët e të ndjerit duhet të njoftojnë Komunën ose koncesionarin – drejtpërdrejt ose nëpërmjet Bashkësisë Fetare përkatëse – për organizimin e varrimit brenda 48 orëve nga konstatimi i vdekjes
- Kufoma duhet të varroset brenda 48 orëve pas miratimit të lejes për varrim, përveç rasteve të veçanta ku është i nevojshëm një afat më i gjatë.
- Koncesionari duhet të lajmërohet së paku 5 orë para varrimit dhe është i obliguar të sigurojë shërbimet e nevojshme për hapjen dhe mbulimin e varrit.
- Leja për varrimin e të vdekurit lëshohet nga Zyra e gjendjes civile në Komunë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

#### **10.3. Mbështetja komunale**

Për familjet me kushte të vështira ekonomike, komuna mbulon shpenzimet bazë të varrimit nga fondet e subvencionimit. Gjithashtu, Komuna përmes vendimeve të veçanta rregullon çështjen e mbulimit të shpenzimeve të tjera, ngjashëm me praktikën e deritanishme.

#### **10.4. Zhvarrimi**

Procedurat e zhvarrimit (zhvarrimi i zakonshëm dhe ai i jashtëzakonshëm) duhet të kryhen në përputhje me dispozitat ligjore dhe në koordinim me komunën. Zhvarrimi i jashtëzakonshëm lejohet vetëm për arsye të veçanta dhe kërkon miratim nga autoritetet kompetente.

1. **Zhvarrosja e Zakonshme:** Kryhet pas periudhës së prehjes prej së paku 10 vitesh.

2. Zhvarrosja e Jashtëzakonshme: Lejohet për arsye kriminalistike, hetime ligjore, ose transferim në një vend tjetër.
3. Zhvarrosja kryhet vetëm me leje nga inspektorati sanitar dhe në prani të përfaqësuesve të autorizuar.

### **Neni 11 - Bartja e Kufomës**

1. Bartja e kufomës kryhet me mjete të specializuara dhe në përputhje me rregullat sanitare.
2. Kompanitë përkatëse ofrojnë shërbim 24/7 për rastet emergjente.
3. Për bartjen jashtë orareve të zakonshme, kërkohet njoftim paraprak nga familjarët e të ndjerit.

### **Neni 12 - Lejet për Zhvarrosje dhe Relokim**

1. Zhvarrosja kryhet vetëm me miratimin e komunës dhe inspektoratit sanitar apo organit kompetent, në prani të Policisë së Kosovës, mund të bëhet zhvarrosja (nxjerrja) e mbetjeve të kufomës për t'u bartur – rivarrosur në një vend varrezë tjetër ose për çështje tjera,
2. Lidhur me pikën 1 të këtij neni mbahet procesverbali nga ana e organit kompetent ose personit tjetër të autorizuar për këtë çështje dhe i nënshkruar nga palët,
3. Zhvarrosja e jashtëzakonshme kryhet për arsye kriminalistike, transferimi, ose interes publik.
4. Dokumentacioni i nevojshëm për zhvarrosje përfshin, por pa u kufizuar:
  - o Lejen e lëshuar nga autoriteti përkatës,
  - o Deklaratën e familjarëve të të ndjerit.
5. Afati minimal i prehjes për një varr është 10 vjet nga data e varrimit,
6. Zhvarrosja dhe relokimi i kufomave duhet të dokumentohen dhe të kryhen në prani të një inspektori sanitar,
7. Shpenzimet lidhur me punën rreth zhvarrosjen dhe zhvendosjes e kufomave mbulohen nga pala e cila e ka kërkuar shërbimin.

### **Neni 13 - Kremimi i Kufomave**

1. Kufomat mund të nënshtrihen kremimit/djegies vetëm në krematorë të licencuar nga autoritetet kompetente.
2. Rregullat për kremimin:
  - o Hiri i kufomës duhet të ruhet në enë të sigurt, të mbyllura hermetikisht.
  - o Hiri mund të varrosset në një varr të veçantë ose të ruhet në hapësira të caktuara për këtë qëllim.

### 3. Leja për kremim:

Jepet vetëm nëse i ndjeri ka lënë testament të vlefshëm ose në përputhje me autorizimet ligjore për raste të veçanta.

## KREU V: SJELLJA NË VARREZA DHE MASAT NDAJ SHKELJEVE

### Neni 14 - Sjelljet gjatë varrimit

1. **Respekti dhe qetësia:** Çdo person që hyn në varreza duhet të sillet me respekt maksimal ndaj vendit të shenjtë të prehjes së të vdekurve. Duhet të ruhet qetësia; bisedit me zë të lartë, muzika apo zhurmat e panevojshme nuk lejohen brenda varrezave.
2. **Rregullat e përgjithshme:** Vizitorët lejohen të vizitojnë varrezat çdo ditë gjatë orëve të ditës. Pas orës 22:00 deri në agim, hyrja e publikut mund të kufizohet për arsye sigurie (p.sh. porta mund të mbyllet gjatë natës).
3. **Fëmijët:** Fëmijët nën moshën 10 vjeç lejohen të hyjnë në varreza vetëm nën kujdesin e prindit ose një të rrituri përgjegjës, për t'i mbikëqyrur dhe për t'i mësuar që të sillen me respekt.

### Neni 15 - Sjellja e Vizitorëve në Varreza

1. Vizitorët duhet të tregojnë respekt dhe të ruajnë qetësinë në sipërfaqen e varrezave.
2. Ndalohet:
  - **Dëmtimi ose ndotja e varreve dhe monumenteve:** Ndalohen çdo lloj vandalizmi, shkelje apo kapërcim mbi varre, thyerja e lapidarëve, rrethojave apo objekteve përkujtimore.
  - **Prishja e rendit publik:** Ndalohen veprimet që prishin qetësinë, si p.sh. bërtitjet, grindjet, përdorimi i pajisjeve muzikore me zë të lartë, apo çdo sjellje tjetër e pahijshme.
  - **Ndërrhyrje pa leje:** Ndalohen mbjellja e drunjve, luleve apo shkurreve në mënyrë individuale pa miratimin e administratës së varrezave, si dhe vendosja e objekteve dekorative të mëdha që dalin jashtë kufijve të varrit. Po ashtu ndalohet çdo ndërtim apo gërmim pa autorizim (përfshirë hapjen e një varri pa leje zyrtare).
  - **Reklamimi dhe veprimtaritë komerciale:** Shpërndarja e fletushkave, reklamave, kryerja e shitjeve ambulante (si shitës lulesh apo të ngjashme) brenda varrezave është e ndaluar pa leje të posaçme. Fotografimi ose filmimi për qëllime komerciale/profesionale brenda varrezave lejohet vetëm me leje paraprake nga Komuna.

- **Hedhja e mbeturinave:** Ndalohen hedhja e plehrave, luleve të vyshkura, qirinje të konsumuar apo objekteve tjera jashtë koshave të caktuar. Varri i secilit duhet të mbahet i pastër; sendet e vendosura (kurora, lule) që janë tharë duhet të largohen brenda një afati të arsyeshëm.
- **Kutja e kafshëve:** Ndalohet hyrja e kafshëve shtëpiake në varreza pa leje dhe pa kontroll. Përjashtim mund të bëhet vetëm për qentë udhërrëfyes të personave të verbër.
- **Automjetet e paautorizuara:** Ndalohet hyrja e veturave private, motoçikletave ose biçikletave brenda varrezave pa leje të administratës, përveç automjetet funerale ose automjetet e shërbimit të mirëmbajtjes.
- **Lypja dhe shqetësimi:** Ndalohet qëndrimi i lypsarëve ose ofrimi i shërbimeve të tjera brenda dhe në hyrje të varrezave.
- **Ndezja e zjarreve:** Ndezja e qirinje lejohet vetëm në vendet e posaçme, si mbajtëse qirinjsh apo baza të sigurta dhe në pajtim me traditën fetare. Ndezja e zjarreve të hapura, djegia e sendeve mbi varr është e ndaluar për shkak të rrezikut të zjarrit dhe ndotjes së ajrit.

### 3. Personeli dhe kontrolli

Personeli i Koncesionarit (rojet apo administratorët e varrezave) ka të drejtë t'u tërheqë vëmendjen vizitorëve që shkelin rregullat e mësipërme, dhe të njëjtat do të raportohen tek Komuna. Në raste serioze, ata mund të kërkojnë asistencën e Policisë së Kosovës. Çdo dëmtim i qëllimshëm i pronës komunale (varre, objekte) do të ndiqet sipas ligjit.

## Neni 16 – Masat ndëshkuese

### 1. Gjjobat administrative

Shkelja e dispozitave të kësaj Rregulloreje nga individët apo subjektet do të ndëshkohet me gjjobë, sipas kategorizimit si më poshtë:

- Për **personin fizik (individ):** gjjobë nga 10€ deri në 100€ për secilën shkelje (varësisht nga shkalla e dëmtimit apo prishjes së rendit).
- Për **personin fizik që ushtron veprimtari (biznes) individuale** brenda varrezave pa leje: gjjobë nga 30€ deri në 250€.
- Për **personin përgjegjës të personit juridik** (p.sh. përgjegjësi i një kompanie që kryen punime pa leje në varreza): gjjobë nga 30€ deri në 250€.
- Për **personin juridik** (kompani, OJQ, institucion) që shkel rregullat (p.sh. dëmton pronën publike në varreza, kryen aktivitete pa leje): gjjobë nga 100€ deri në 1500€.

### 2. Sanksionet shtesë

Përveç gjjobave të lartpërmendura, Komuna ka të drejtë të marrë masa shtesë ndaj shkelësve: t'u revokojë lejet (nëse janë operatorë të licencuar që abuzojnë), t'i ndalojë përkohësisht hyrjen në varreza, si dhe të kërkojë ndjekje penale në raste vandalizmi të rëndë apo cenimi flagrant të rendit.

### 3. Organi kompetent:

Zbatimin e gjobave dhe masave e bën Inspektorati Komunal në bashkëpunim me organet e rendit. Inspektorët komunalë kur konstatojnë shkeljen, përpilojnë procesverbalin dhe vendimin për gjobë në vend. Shkelësi ka të drejtë ankese ndaj gjobës sipas procedurave ligjore (brenda afatit ligjor në organin kompetent komunal).

### 4. Përdorimi i të hyrave nga gjobat

Të hyrat e mbledhura nga gjobat administrative derdhen në buxhetin e Komunës së Prizrenit dhe preferohet të destinohen për mirëmbajtjen dhe sigurinë e varrezave (p.sh. për investime në sisteme mbikëqyrjeje, rritjen e patrullimit apo riparimin e dëmeve të shkaktuara).

## KREU VI: TARIFAT DHE ARKËTIMI I TË ARDHURAVE

### Neni 17 - Caktimi dhe Arkëtimi i Tarifave

Ky nen përcakton procedurat dhe përgjegjësitë për caktimin, ndryshimin, dhe arkëtimin e tarifave për shërbimet e varrimit dhe mirëmbajtjes së varrezave. Synimi është të sigurohen tarifa të përballueshme, të bazuara në drejtësi dhe transparencë.

#### 17.1. Caktimi i Tarifave

- Tarifat për shërbimet bazë të varrimit dhe mirëmbajtjes përcaktohen nga koncesionari, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës së koncesionit.
- Këto tarifa duhet të reflektojnë kostot reale dhe të garantojnë përballueshmëri për të gjitha grupet sociale.
- **Miratimi dhe Publikimi:** Tarifat miratohen nga organet kompetente të Komunës dhe publikohen në mënyrë transparente në platformat zyrtare.

#### 17.2. Kategoritë e Tarifave

##### 1. Tarifat e Rregulluara

- Përfshijnë tarifat për shërbimet bazë, si hapësirat për varrime individuale ose (kur aplikohet) familjare dhe mirëmbajtja standarde e varrezave.
- Këto tarifa përcaktohen nga Komuna në bashkëpunim me koncesionarin, duke përfshirë një proces formal të:
  - Hartimit të një propozimi nga koncesionari.
  - Shqyrtimit dhe miratimit nga organet komunale.
- **Rishikimi Periodik:** Tarifat e rregulluara shqyrtohen të paktën çdo dy vjet për të pasqyruar ndryshimet në:
  - Kostot operative.
  - Inflacionin dhe kushtet ekonomike.
  - Ndikimit mbi qytetarët dhe rrethanave ekonomike.

##### 2. Tarifat e Parregulluara

- Përfshijnë shërbime shtesë dhe opsionale, duke përfshirë por pa u kufizuar në :
  - Ceremonitë e personalizuara,
  - Dekorimet dhe elementet estetike,
  - Rezervimet e varreve,
  - Përdorimi i hapësirave për ngjarje të veçanta.
- Vëndosen dhe menaxhohen nga koncesionari në mënyrë të pavarur, me detyrimin për të:
  - Raportuar të ardhurat nga këto tarifa tek Komuna.
  - Publikuar listën e tarifave në mënyrë transparente.
- **Ndryshimi i Tarifave Komerciale:** Çdo ndryshim duhet të jetë i justifikuar dhe i mbikëqyrur nga Komuna për të shmangur abuzimet.

### 17.3. Procesi i Miratimit dhe Mbikëqyrjes së Tarifave

#### 1. Propozimi dhe Miratimi:

- Koncesionari dorëzon një propozim të detajuar për tarifën e reja ose ndryshimet, duke përfshirë një analizë financiare dhe ndikimin.
- Komuna shqyrton dhe miraton propozimet duke siguruar përputhshmëri me kontratën dhe interesat publike.

#### 2. Publikimi i Tarifave:

- Tarifat e miratuara publikohen në:
  - Faqet zyrtare të Komunës dhe Koncesionarit.
  - Hyrjet e varrezave.

#### 3. Monitorimi dhe Rishikimi:

- Komuna dhe Koncesionari bashkëpunojnë për të monitoruar zbatimin dhe efektivitetin e tarifave.
- Rishikimet kryhen rregullisht për të siguruar përputhje me standardet sociale dhe ligjore.

### 17.4. Arkëtimi i Tarifave

Koncesionari ka të drejtë, si dhe është ekskluzivisht dhe tërësisht përgjegjës për arkëtimin, mbledhjen, pranimin, depozitimin dhe mbajtjen e të gjitha tarifave gjatë kohëzgjatjes së kontratës si dhe bartë rrezikun në lidhje me këtë. Arkëtimi i tarifave kryhet në përputhje me dispozitat përkatëse të Kontratës së koncesionit, si dhe vendimeve specifike të Autoritetit Kontraktues – Komunës së Prizrenit, apo të nivelit qendror.

### 17.5. Transparenca dhe Informimi Publik

#### 1. Informimi i Qytetarëve

Koncesionari dhe Komuna kanë për detyrë të informojnë qytetarët mbi strukturën dhe arsyetimin e tarifave, duke siguruar transparencë të plotë përmes organizimit të fushatave ndërgjegjësuëse dhe vendosjes së tabelave informuese në vendet e përcaktuara.

#### 2. Publikimi i Çmimeve dhe Planit të Tarifave

Plani i tarifave për shërbimet e varrimit dhe mirëmbajtjes së varrezave publikohet si shtojcë e kontratës së koncesionit dhe përfshihet si pjesë integrale e kësaj rregulloreje.

- **Hapësirat e Publikimit:**

- **Hyrjet e Varrezave:** Çmimet dhe tarifat duhet të jenë të dukshme dhe lehtësisht të lexueshme për të gjithë qytetarët.
- **Faqet Zyrtare të Internetit:**
  - Të Komunës.
  - Të Koncesionarit, kur është e aplikueshme.

## **KREU VII: STANDARDET E MIRËMBAJTJES DHE INSPEKTIMI**

### **Neni 18 - Standardet e Mirëmbajtjes dhe Operimit**

Ky nen përcakton standardet për mirëmbajtjen dhe operimin e varrezave të reja, duke siguruar që koncesionari të përmbushë kërkesat teknike dhe mjedisore të përcaktuara në kontratën e koncesionit:

#### **18.1. Standardet e Shërbimeve**

Shërbimet e ofruara nga koncesionari duhet të jenë të cilësisë së lartë dhe të sigurojnë një përvojë dinjitoze për qytetarët që vizitojnë varrezat. Standardet përfshijnë:

1. Respektimin e praktikave kulturore dhe fetare gjatë shërbimeve të varrimit.
2. Përdorimin e materialeve dhe metodave të qëndrueshme për mirëmbajtje dhe ndërtim.

#### **18.2. Detyrimet për Mirëmbajtje Periodike**

Koncesionari është i detyruar të kryejë mirëmbajtjen e vazhdueshme të varrezave dhe infrastrukturës përkatëse, duke përfshirë:

1. Hapësirat e gjelbra dhe rrugët brenda varrezave.
2. Infrastruktura e ndriçimit dhe furnizimit me ujë.
3. Menaxhimi dhe mbledhja e mbetjeve të krijuara brenda hapësirës së varrezave.
4. Mirëmbajtja duhet të kryhet në përputhje me standardet teknike dhe mjedisore të përcaktuara në kontratën e koncesionit dhe rregulloret lokale.

#### **18.3. Inspektimi dhe Monitorimi nga Komuna**

Komuna do të kryejë inspektime të rregullta për të monitoruar përmbushjen e detyrimeve nga ana e koncesionarit. Inspektimet do të përqendrohen në:

1. Cilësinë e mirëmbajtjes së hapësirave.
2. Respektimin e standardeve teknike dhe rregulloreve mjedisore.
3. Efikasitetin e operimeve dhe funksionimin e infrastrukturës së varrezave.

#### **18.4 Raportimi dhe Përmirësimet**

Koncesionari është i obliguar të dorëzojë raporte periodike tek Komuna, duke përfshirë:

1. Raportet e mirëmbajtjes dhe shpenzimeve operative.
2. Sugjerime për përmirësime të mundshme në strukturën dhe funksionalitetin e varrezave.
3. Komuna ka të drejtë të kërkojë përmirësime në rastet kur cilësia e shërbimeve nuk është në përputhje me kontratën.

#### **18.5. Ndërhyrjet Emergjente**

Në raste të situatave emergjente, si dëmtime të infrastrukturës ose ndotje të mjedisit, koncesionari është i detyruar të ndërhyjë menjëherë dhe të adresojë problemet brenda një afati të arsyeshëm.

#### **18.6. Pajisjet e Emergjencës**

Koncesionari duhet të ketë pajisjet e nevojshme për situata emergjente, siç janë shërbimet e zjarrfikësve dhe sigurisë.

### **Neni 19 - Inspektimi dhe Monitorimi nga Komuna**

#### **19.1. Inspektimet e Rregullta**

Komuna do të inspektojë periodikisht varrezat për të siguruar përputhjen me këtë rregullore dhe kontratën e koncesionit.

Inspektimi do të bëhet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Inspektoriati Sanitar.

Në rast të mosrespektimit të akteve të përshkruara si më lartë, pas tre (3) vërejtjeve të njëpasnjëshme, Komuna do të ndërmerr masa konform kësaj rregulloreje dhe masave të parapara në Kontratë.

#### **19.2. Mbajtja e Regjistrave**

Koncesionari është i detyruar të mbajë regjistra të detajuar të shërbimeve dhe aktiviteteve të mirëmbajtjes, të cilët do t'i paraqiten komunës me kërkesë.

#### **19.3. Masat Ndëshkimore për Mos-përbushje**

Në rastet e mos-përbushjes së detyrimeve, komuna do të aplikojë masa ndëshkimore në përputhje me kontratën dhe këtë rregullore. Këto përfshijnë gjoba ditore për vonesa në përfundimin e punimeve apo për shkelje të standardeve të shërbimit.

## **KREU VIII: ZBATIMI DHE DISPOZITAT PËRFUNDIMTAR**

### **Neni 20 - Mbikëqyrja**

Komuna vendos për autoritetin monitorues dhe inspektues të kësaj rregulloreje, duke u bazuar në kompetencat e Komunës si dhe obligimet që dalin nga Kontrata e Koncesionit. Komuna dhe koncesionari inspektojnë dhe monitorojnë zbatimin e kësaj rregulloreje për të siguruar respektimin e saj.

## **Neni 21 - Përgjegjësitë Ligjore të Palëve**

### **21.1. Përgjegjësitë e Koncesionarit:**

Koncesionari mban përgjegjësinë e plotë për:

1. Zbatimin e të gjitha detyrimeve të përcaktuara në kontratë.
2. Respektimin e standardeve teknike dhe mjedisore të përcaktuara në rregullore dhe kontratën e koncesionit.
3. Sigurimin e të gjitha burimeve financiare dhe teknike për funksionimin dhe mirëmbajtjen e varrezave.
4. Në rast të shkeljeve të kontratës ose mosrespektimit të kushteve, koncesionari do të jetë përgjegjës për kompensimin e dëmeve të shkaktuara Komunës ose qytetarëve.

### **21.2. Përgjegjësitë e Komunës:**

Komuna është përgjegjëse për:

1. Sigurimin e një kuadri ligjor dhe administrativ të përshtatshëm për funksionimin e projektit.
2. Mbikëqyrjen dhe monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të kontratës nga koncesionari.
3. Lehtësimin e proceseve të licencimit dhe dhënies së lejeve për koncesionarin.
4. Në rast të mosrespektimit të përgjegjësive të saj, Komuna mund të përballë me detyrimin për të kompensuar koncesionarin për vonesat ose dëmet që rrjedhin nga veprimet ose mosveprimet e saj.

## **Neni 22 - Harmonizimi me Ligjet dhe Rregulloret Lokale**

### **22.1 Përputhshmëria me Legjislacionin në Fuqi**

Kjo rregullore duhet të jenë në përputhje të plotë me:

1. Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokal;
2. Ligjin Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat;
3. Kontratën e Koncesionit për projektin "Partneriteti Publiko Privat, Varrezat e Reja në Fshatin Landovicë të Prizrenit";
4. Rregullore (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës
5. Rregulloret komunale për varrezat dhe ofrimin e shërbimeve të varrimit;
6. Legjislacionin e Kosovës mbi mjedisin dhe shërbimet publike, si dhe të gjitha ligjet e ndërlidhura, dhe çdo dispozitë e kësaj Rregulloreje që bie ndesh me ligjet në fuqi, epërsi do të kenë dispozitat ligjore.

## 22.2. Amendimi i Rregullores

Në rast të ndryshimeve në legjislacionin lokal ose qendror, kjo rregullore do të pësojë ndryshime për të siguruar përputhshmërinë me normat e reja.

## Neni 23 - Dispozitat Përfundimtare

### 23.1. Dispozitat Kalimtare

Kjo rregullore do të zbatohet për të gjitha shërbimet dhe aktivitetet e përcaktuara, duke përfshirë periudhën e tranzicionit deri në përfundimin e adaptimit të plotë të infrastrukturës dhe praktikave të reja.

### 23.2. Interpretimi i Rregullores

Në rast të paqartësive ose mospërputhjeve, interpretimi i rregullores do të bëhet duke iu referuar kontratës së koncesionit dhe legjislacionit në fuqi.

### 23.3. Dispozitat Shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, të gjitha aktet dhe vendimet e mëparshme që bien në kundërshtim me të shfuqizohen.

## Neni 24 - Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës dhe shtatë (7) ditë pune pas publikimit në ueb-faqen e Komunës së Prizrenit dhe publikimit në ueb-faqen e Gazetës Zyrtare, dhe mbetet e vlefshme gjatë gjithë periudhës së zbatimit të marrëveshjes së koncesionit. Komuna e Prizrenit është përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e kësaj Rregulloreje.



**Shtojca I. Plani i tarifave për shërbimet e varrimit dhe mirëmbajtjes së varrezave**

## **Shtojca 2. Detajet rreth përmasave të varreve**


Të shtohet (opsionale):

- ..... 7. Detaji i Varrezave bektashiane
  - 8. Detaji i Varrezave hebreje
  - 9. Detaji i Varrezave protestante
- 
-

DETAJI I VARREZËS MUSLIMANE P=1:30

Prejra A-A

Prejra B-B





		VARRKAT E QYTETE TE REJA - PRITREN		FZ GRUPE	
Nr. 107/17 Prizren NENKURORTI BASHKICITETI (Kryeqendri i Prizrenit)		HARRISHT PROJEKTI I ERREZES TE VARREZAVE TE REJA LANOVCIVE, PRAJEN SIPAS RREGULLIT PER PLANIN ZONAL URBAN		PZ GRUPE	
01/17		01/17		Landovicë, Prizren	
09.2017		Bekara Maxh Basha, Arif		1:30	
1/3		Xhavit Halil Haxhi, Idriz, Nohat Haxhi		A-15	




DETAJI I VARREZËS ORTODOKSE P=1:30

PRERJA A - A

PRERJA B - B



		VARREZALË GJITHI TË REJA - PRIZREN		PRERJE	
HARRINGU I PROJEKUT KRYESOR TË VARREZAVE TË REJA LANDOVICË PRIZREN SIPAS FUNDLIVIT DITË PLANILINDARISË		HARRINGU I PROJEKUT KRYESOR TË VARREZAVE TË REJA LANDOVICË PRIZREN SIPAS FUNDLIVIT DITË PLANILINDARISË		H2 GROUP	
TITULLI DETAJI I VARREZËS ORTODOKSE	LOKALITETI Landovicë, Prizren	SHTETI Shqipëri	DOKUMENTI HARRINGU I PROJEKUT KRYESOR TË VARREZAVE TË REJA LANDOVICË PRIZREN SIPAS FUNDLIVIT DITË PLANILINDARISË	MASHTABI 1:30	DATUMI 07.2017
AUTORI Besarta Halimi Sach, Ansh	DOKUMENTI HARRINGU I PROJEKUT KRYESOR TË VARREZAVE TË REJA LANDOVICË PRIZREN SIPAS FUNDLIVIT DITË PLANILINDARISË	SHTETI Shqipëri	DOKUMENTI HARRINGU I PROJEKUT KRYESOR TË VARREZAVE TË REJA LANDOVICË PRIZREN SIPAS FUNDLIVIT DITË PLANILINDARISË	MASHTABI 1:30	DATUMI 07.2017
AUTORI Xhevdet Halimi Inxh. i Dg. i Ndërtimtarisë	DOKUMENTI HARRINGU I PROJEKUT KRYESOR TË VARREZAVE TË REJA LANDOVICË PRIZREN SIPAS FUNDLIVIT DITË PLANILINDARISË	SHTETI Shqipëri	DOKUMENTI HARRINGU I PROJEKUT KRYESOR TË VARREZAVE TË REJA LANDOVICË PRIZREN SIPAS FUNDLIVIT DITË PLANILINDARISË	MASHTABI 1:30	DATUMI 07.2017

Regullore për Varrim dhe Mirëmbajtjen e Varrezave të Reja të Prizrenit në Landovicë

Fq. 24/24